



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN KOORDINIMIT DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3297 / Prot.

Patos, më 21 / 01 / 2022

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot në datë 21.01.2022 ora 11:00 në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos ku organizohet seanca dëgjimore lidhur mbi “ Fillimin e procedurës së privatizimit nga ana e Bashkisë të objektit “ Ish zyrat e NFP-së” pasuria me nr 6/15 e ndodhur në Zonën Kadastrale 2890 në pronësi të Bashkisë Pato”

Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. Sekretari i Këshillit
2. Banorë të objektit me nr.pasurie 6/15
3. Përfaqësues të Shoqërisë Civile
4. Përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë

Takimi hapet nga Sekretari i Këshillit Bashkiak z. Balil Balili

Balil Balili – Mirwdita. Përpara se të fillojmë më lejoni që në radhë të parë t’ju falenderoj për pjesëmarrjen në këtë takim. Këshilli i Bashkisë ka detyrimin ligjor që të organizojë takime konsultative me banorë por edhe me grupe interesi. Ju si banorë të objektit më nr. Pasurie 6/15, e njohur ndryshe si ish zyrat e NFP-së, keni dërguar një kërkesë Bashkisë për privatizimin e saj. Ne si Këshill Bashkiak e kemi miratuar kërkesën tuaj dhe kemi dalw me vendim për fillimin e procedurës së privatizimit nga ana e bashkisë por na e ka kthyer Prefektura këtë vendim duke qenë se nuk është realizuar dëgjesa publike me ju dhe grupe interesi. Juristja e bashkisë do t’ju sqarojë gjithë procedurën qw duhet ndjekur.

Nurkë Hazizaj – me shkresën nr. 2960 prot datë 17.11.2021 ju si banorë të objektit të ISH-Zyrave të NFP-së Patos i jeni drejtuar Bashkisë me kërkesë për kalimin e pronësisë nga bashkia në pronësinë tuaj duke qenë se ju jetojini në këtë ndërtesë për më shumë se 30 vjet. Kjo procedurë është edhe në interesin e bashkisë pasi mirmbajtja e objektit është një kosto financiare për ne dhe

po prap nga ana tjetër ju si banorë që jetojini në këtë godinw nuk mund të pajiseni me leje pwr rikonstruksion apo mirëmbajtje të zakonshme për arsyen e vetme se ju nuk dispononi dokumentacion pronësie.

Selam Rrapaj – ne e kemi marrw me vendim dhe duam dokumentin e shtwpisw

Nurkw Hazizaj – qw ju ta jeni mw tw qartw, pwr procedurwn e privatizimit i jemi referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014dhe Udhëzimit nr.10 datë 12.4.2018 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.5222 datë 26.6.2015 Ministra Përgjegjëse për Ekonominë nxjerr urdhërin e miratimit të privatizimit. Pasi të meret Vendimi nga ana e Këshillit të Bashkisë dhe konfirmimi nga prefekti mbi ligjshmërin e vendimit,Nashkia Patos I drejtohejtohet me kërkesë Ministrisë Përgjegjëse për Ekonominë për privatizimin e kësaj pasurie. Ministria nxjerr urdhërin për miratimin e privatizimit dhe komisioni për vlerësimin e pronës që do të privatizohet ngrihet nga Ministria. Ky komision ka në përbërje 3 anëtarë që janë Kryetari i Degës së Shoqërive Publike, në prefekturën ku ndodhet objekti në cilësinë e kryetarit të komisionit Një ekspert i licensuar (në cilësinë e anëtrir dhe një përfaqësues nga bashkia përsëri anëtarë.

Balil Balili – ndonjë pyetje apo paqartësi për procedurën?

Baki Xhemalaj – nga ana jonë cfarë kërkohet tjetër?

Nurkë Hazizaj – nga ana juaj është bërë një kërkesë

Marie Mukaj – ne duam të marrim certifikatën e pronësisë pasi kemi 30 vjet që jetojmë aty ndaj bashkia duhet të na e japi atë.

Nurkë Hazizaj – sic e sqarova edhe parë privatizimin e bën Ministria e Ekonomisë dhe bashkia ka filluar vetëm procedurën e privatizimit

Arben Mucaj – në momentin e certifikimit do kryen shit-blerje?

Balil Balili – sa për sqarim, këto objekte Bashkisë i janë kaluar me VKM dhe duhet te kryhen keto procedura por ajo qe është përparësi për ju është që ju do të vazhdoni të jetoni aty.

Muhamet Shehu – unë kam një shtesë edhe ajo do të certifikohet?

Arben Shpërdheja – ne do të fillojmë vetëm procedurën për privatizimin e objektit që ju keni marrë me vendim. Lidhur mbi shtesat apo ndërtimet pa leje që ju keni bërë duhet ti drejtoheni Aluiznit për fillimin e procedurës së legalizimit. Bashkia nuk certifikon prona aq më tepër kur bëhet fjalë për ndërtime pa leje.

Balil Balili – po e theksoj prap që ajo që është më e rëndësishme është fakti se asnjë banorë nuk do të lëviz nga banesa e tij.

Mimoza Gjata – nuk duam gjë tjetër vetëm lëvizini të gjitha gurët që ne të marrim certifikatën e pronës.

Balil Balili –dhe ne këtë po përpiqemi të bëjmë, ndonjë pyetje apo paqartësi lidhur mbi fillimin e procedurës së provatizimit nga ana e bashkisë të godinës? Mqse jo unë ju falenderoj që ishit prezent në këtë takim i cili padyshim që i hap rrugë këshillit për ta miratuar si venim. Edhe një herë faleminderit.

Koordinator
Për Konsultimin Publik
Suzana Hysenaj

